



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 03, Datë 14.06.2016

PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRUAR NDËRSEKTORIAL PËR ZONËN
EKONOMIKE TIRANË - DURRËS

Në mbështetje të neneve 7, 8, 17 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 671, datë 29.07.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të Vendimit Nr. 2 datë 08.04.2014 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e nismës për hartimin e Planit të Integruar Ndërsektorial për Zonën Ekonomike Tiranë-Durrës”, si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Zhvillimit Urban, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e “Planit të Integruar Ndërsektorial për Zonën Ekonomike Tiranë-Durrës”.
2. Pjesë përbërëse e Planit të Integruar Ndërsektorial për Zonën Ekonomike Tiranë-Durrës janë:
 - a) Relacioni, i cili përmban:
 - i. Dokumentin e analizës;
 - ii. Vizionin dhe objektivat strategjike të zhvillimit;
 - iii. Propozime me përcaktime territoriale;
 - iv. Planin e veprimeve dhe projektet e investimeve strategjike.
 - b) Rregullorja e planit;
 - c) Materiali grafik (Hartat);
 - d) Studimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor.
3. Ngarkohen të gjithë autoritetet përgjegjëse të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, për zbatimin e Planit të Integruar Ndërsektorial për Zonën Ekonomike Tiranë-Durrës.

4. Gjatë hartimit të planeve sektoriale kombëtare, planeve të detajuara për zona të rëndësishme kombëtare, planeve sektoriale në nivel qarku, planeve të përgjithshme vendore, projekteve strategjike dhe pilot të zhvillimit, si dhe çdo projekti për zhvillimin e territorit, autoritetet përgjegjëse të planifikimit duhet të bazohen në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga Plani i Integruar Ndërsektorial për Zonën Ekonomike Tiranë-Durrës.
5. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për kontrollin e përputhshmërisë së dokumenteve të planifikimit që hartohen nga autoritetet përgjegjëse të planifikimit të territorit, me përcaktimet e Planit të Integruar Ndërsektorial për Zonën Ekonomike Tiranë-Durrës.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA

ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN

SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT